



Republika e Kosovës

Republika Kosovo/Republic of Kosovo

Komuna Dragash/ Opština Dragaš/Dragas Municipality



KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

Ne baze të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, bazuar në nenin 25 të Ligjit nr.08/L-185 për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore, bazuar në Rregulloren nr.01/2025 për mekanizmin koordinues lokal për mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore, nenit 56 të Statutit të Komunës së Dragashit - 01 Nr.06-103/1 të datës 11.09.2008, Kuvendi i Komunës në Dragash në mbledhjen e mbajtur me datën, 26.02.2026 miraton këtë:

V E N D I M

- I. Themelohet Mekanizmi Lokal Koordinues për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Bazë Gjinore, në përbërje prej:
1. Z. Bexhet Xheladini – Kryetar,
 2. Z. Behar Brenoli – Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale,
 3. Z. Ibrahim Gashi – Drejtor i QPS-së,
 4. Znj. Lulbardha Berisha – Qengaj – Udhëheqëse e Shërbimeve Sociale - QPS,
 5. Z. Zeni Krasniqi – Drejtor i Drejtorisë Komunale të Arsimit,
 6. Znj. Lindita Kozmaqi – Piraj – Zyra për Barazi Gjinore,
 7. Z. Nazmi Velija – Drejtor i Qendrës Kryesore Familjare,
 8. Z. Uzair Hamza – Udhëheqës i Zyrës për Komunitete,
 9. Znj. Jubilea Kabashi – Përfaqësuese nga Strehimorja,
 10. Z. Adem Emini – Sekretar i Mekanizmit,
 11. Përfaqësues nga OJQ-të _____,
 12. Përfaqësues nga Mbrojtja e Viktimave nga Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave,
 13. Përfaqësues nga Gjykata,
 14. Përfaqësues nga Prokuroria,
 15. Përfaqësues nga Policia,
 16. Përfaqësues nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas,
 17. Përfaqësues nga Zyra e Punësimit,
 18. Përfaqësues nga Qendra e Shëndetit Mendor.

- II.** Mekanizmi Koordinues Lokal koordinon aktivitetet për parandalimin, mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të të gjitha formave të dhunës pa diskriminim në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë bazë tjetër me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.
- III.** Ky Mekanizëm lokal Koordinues do t'i kryej detyrat dhe përgjegjësitë në përputhje me Ligjin nr.08/L-185 për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore, ne pajtim Rregulloren (QRK) 01/2025 për Mekanizmin Koordinues Lokal për Mbrojtje nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore.
- IV.** Vendimi, hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8 dhe nenit 9 të Ligjit Nr.08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 24/2024'' dhe pas publikimit në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

01-Nr- 060/01 - 2909 - 3/26
Datë 26.02.2026



Kryesuesi i Kuvendit

Resul Fetahu
Resul Fetahu